



KOMUNA E MALISHEVËS

BULETINI



Nr. 100-Tetor 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga punimet e nënkalimit në Astrazup, rrugës në Fshat të Ri dhe parkut në Mirushë



Përmbajtja

Furnizimi me ujë i kënaqshëm	2
Kryetari Kilaj priti në takim zëvendëskomandantin e KFOR-it Gjeneralin LUIF	4
Qeveria Komunale mbajti mbledhjen e rregullt	5
Kryetari Kilaj priti në takim përshëndetës kapitenin Cristoph të LMT-së	5
Filloi ndërtimi i Parkut të Gjellbër në Mirushë	6
Në shtatë vjetorin e aksidentit, përkujtohen 15 maturantët	7
Filloi ndërtimi i nënkalimit në Astrazup	8
RCPI do të hap pusin e ujit për shkollën e Astrazupit	8
Komiteti për Arsim mbajti mbledhjen e dytë të radhës	9
Komuna dhe FSK-ja ndërtojnë rrugën në Fshatin e Ri	9
Diskutohet për hallet dhe problemet e tyre	10
Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e rrugës në fshatin Rud	11
Raportohet për fillim vitin 2011-2012 dhe miratohet raporti për zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave	11
Tafaj: Qendra e Kompetencës, shkollë me standarde evropiane	12



Furnizimi me ujë i kënaqshëm

Malishevë, 3 tetor

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, është diskutuar gjendja e furnizimit me ujë për pije, nga ujësjellësit aktual. Është konstatuar se furnizimi nga shumica e ujësjellësve, është 24 orë në ditë, ndërsa shumë shpejt pritet që edhe disa fshatra tjerë të kyçen në sistemet e ujësjellësve.

Në këtë mbledhje, për gjendjen e furnizimit me ujë, ka raportuar menaxheri i njësisë në Malishevë, të Hidroregjionit Jugor, Njazi Bytyçi, i cili tha se “aktualisht nga ujësjellësi kryesor, për Malishevën, furnizimi është 24 orë në ditë, ndërsa tashmë edhe fshati Carrallukë, po furnizohet me ujë”. “Edhe në ujësjellësit tjerë po ashtu furnizimi është shumë i mirë, ndërsa nesër pritet që me ujë të filloj të furnizohet edhe fshati Maxharrë, kurse në Dragobil, do të fillohet me vendosjen ujëmatësve nga kjo javë”, tha Bytyçi. Ai po ashtu njoftoi edhe për marrëveshjet me disa fshatra, të cilat kanë ujësjellës, që të futen nën menaxhimin e kësaj kompanie.

Drejtori i urbanizimit, Esat Paçarizi, ka bërë të ditur se nesër, pritet të bëhet pranimi teknik i ujësjellësit në fshatin Burim, përderisa kërkoi të sqarohet çështja e menaxhimit të kanalizimit të ujërave atmosferike në qytet, pasi kompania Hidroregjini, nuk është duke i menaxhuar këto kanalizime, dhe si pasojë, shumë prej gypave, tashmë janë mbyllur nga rëra.

Në mbledhjen e sotme, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Zogaj, njoftoi për gjendjen, pas zjarreve, ku bëri të ditur se “në përgjithësi, janë djegur rreth 200 hektar me pyje në territorin e Malishevës”.

Kurse drejtori për bujqësi, Sinan Kryeziu, ka prezantuar disa mundësi për përkrahjen e bujqve, sidomos në fushën e blegtorisë.



Kryetari Kilaj priti në takim zëvendëskomandantin e KFOR-it Gjeneralin LUIF

Malishevë, 7 tetor

Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim Gjeneralin Johann Luif, me ç'rast është biseduar situata e përgjithshme në komunën e Malishevës, por edhe ajo e sigurisë.

Në këtë takim Gjenerali Luif, ka vlerësuar lartë takimet që janë duke u zhvilluar me kryetarët e komunave duke e konsideruar këtë si një bashkëpunim të mirë, që i kontribuuan situatës së sigurisë në Kosovë.

Gjatë këtij takimi kryetari i komunës së Malishevës, ka prezantuar një pasqyrë të përgjithshme të komunës, që nga para, gjatë dhe pas luftës e deri në ditët e sotme. Z. Kilaj shtoj se ndër shqetësimet e tij edhe përkundër shumë investime që janë bërë në komunën e Malishevës, mbetet edhe më tej problemi i ngritjes së infrastrukturës që është në interes të qytetarëve dhe për një jetë më të mirë. Ndërkohë në aspektin e sigurisë kryetari përmendi dy çështje. Duke e vlerësuar të qetë gjendjen e sigurisë në komunë, ai tha se “ ne çmojmë çdo angazhim të KFOR-it në Kosovë, çdo mbështetje të deritashme, mirëpo rasti Kleçka, paraqitet si shqetësim në aspektin e sigurisë, sepse i tërë grupi që po akuzohet është nga komuna jonë, përfshirë këtu edhe deputetin Fatmir Limaj. Njëkohësisht edhe situata e fundit e krijuar në veri të Kosovës, mund të ndikoj të qytetarët e kësaj komuna.

“Ne shpresojmë në qetësimin e situatës në tërësi në veri të Kosovës, por gjithsesi ne duhet të kemi paksa durim në rregullimin e kësaj çështjeje”, u shpreh midis tjerash zëvendëskomandanti i KFOR-it, Gjenerali Johann Luif. Ai poashtu shtoj se është i njoftuar për bashkëpunimin e komunës së Malishevës dhe udhëheqësve të saj, me brigadën e LMT-së që është e stacionuar këtu në Malishevës. Ndërkohë gjenerali, nuk hezitoj të shpreh bindjen se edhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), po i plotëson kushtet që të jetë një ushtri e ardhshme e Kosovës

Në fund të takimit, u shkëmbyen falënderime për bashkëpunimin, ndërkohë që kryetari u shpreh që ndihet i nderuar për këtë vizitë të Gjeneralit Luif.



Qeveria Komunale mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 10 tetor

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i komunës, z. Isni Kilaj, sot mbajti mbledhjen e rregullt të saj, ku u trajtuan disa çështje lidhur me punën e drejtorive komunale, si dhe për aktivitetet gjatë javës në vijim.

Drejtori i Urbanizimit, Esat Paçarizi, njoftoi për fillimin e punimeve në parkun e gjelbër pranë liqenit Mirusha. Sipas tij, punimet pritet të fillojnë nesër (e marte), ndërsa komuna duhet të kryej procedurat e saj për ndërtimin e këtij parku.

Në këtë mbledhje u diskutuan edhe çështje tjera që lidhen me punët e përditshme të komunës dhe drejtorive komunale, përfshirë këtu edhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Kryetari Kilaj priti në takim përshëndetës kapitenin Cristoph të LMT-së

Malishevë, 10 tetor

Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim përshëndetës kapitenin Cristoph të Liaison Monitoring Team (LMT), e cila vepron në këtë komunë, dhe ndërkohë është njoftuar me z. KUONI, i cili do ta merr këtë detyrë.

Me këtë rast, kryetari Kilaj, ka falënderuar kapitenin Cristoph, për veprimtarin e tij në komunën e Malishevës, ndërsa i ka uruar punë të mbarë zëvendësit të tij z. Kuoni.

“Unë ju falënderoj për bashkëpunimin, gjatë kohës sa keni qenë këtu, ndërkohë ju uroj suksese për transferimin tuaj në qendrën e KFOR-it, në Prishtinë, ndërsa z. Kuoni i dëshiroj punë të mbarë dhe i



premtoj se do të vazhdoj bashkëpunimi sikur edhe me paraardhësin e tij”, kështu u shpreh midis tjerash kryetari Kilaj në këtë takim përshëndetës, por edhe njohës njëkohësisht.

Në anën tjetër kapiteni Cristoph, në largim, midis tjerash tha “edhe ne si LMT kemi marr lëvdata nga niveli ynë më i lartë për bashkëpunimin që kemi pas me juve si institucion, prandaj u jemi mirënjohës për këtë bashkëpunim”. Kurse pasardhësi i tij, z. Kuoni shprehi gatishmërinë e tij për ta vazhduar këtë bashkëpunim.

Filloi ndërtimi i Parkut të Gjelbër në Mirushë

Malishevë, 11 tetor

Sot, në Mirushë, në afërsi të liqenit, filloi ndërtimi i Parkut të Gjelbër, projekt i financuar nga BE dhe Komuna e Malishevës, ndërsa kap një sipërfaqe prej rreth 4.5 hektarë, dhe realizohet në kuadër të programit “Beautiful Kosova”. Implementues i projektit është Organizata Ndërkombëtare për Migrim - IOM.

Në ceremoninë e fillimit të punimeve ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës, z. Isni Kilaj, zyrtar dhe këshilltar komunal, përfaqësues të IOM-it dhe banorë të fshatit të Mirushë.

“Kjo është një diçka e mirë që po bëhet, jo vetëm për Mirushën, por për të gjithë Malishevën”, ka thënë kryetari Kilaj, duke iu drejtuar banorëve të fshatit Mirushë, i cili poashtu ka bërë të ditur, se ky është vetëm një pjesë nga i tërë projekti rreth liqenit Mirusha.

Sipas drejtorit të Urbanizmit, Esat Paçarizi, “në këtë fazë të këtij projekti, do të rregullohet parku me rrethojën e saj, rrugicat për ecje dhe mbjellja e drunjve. Të gjitha këto në një sipërfaqe prej rreth 4.5 hektarësh”.



Shuma e projektit, është afro 100 mijë euro, ndërsa do të punojnë rreth 50 punëtor, të cilët janë të regjistruar në Entin për Punësim-Zyra në Malishevë, por përfshihen edhe persona nga shoqata Handikos, shoqata e të verbërve dhe personat në asistencë sociale.

Në shtatë vjetorin e aksidentit, përkujtohen 15 maturantët

Malishevë, 14 tetor

Sot në Malishevë, janë bërë homazhe dhe janë vendosur buqeta me lule, në përkujtim të 15 maturantëve të Gjimnazit “Abdyl Frashëri”, të cilët humbën jetën tragjikisht në afërsi të Fushë Arrëzit, shtatë vite më parë, derisa po ktheheshin pas një ekskursioni të organizuar në Shqipëri.

Homazhe kanë bërë zyrtarët më të lartë komunal të Malishevës, në krye me kryetarin e komunës, z.Isni Kilaj.

Delegacioni i komunës, ka vënë lule pranë lapidarit të ngritur në kujtim të maturantëve, ndërsa dhimbjes së familjarëve, në këtë përkujtim, ia kanë bashkuar edhe nxënësit e Gjimnazit “Abdyl Frashëri” në Malishevë dhe të dy shkollave të mesme tjera, si dhe qytetar të shumtë.

Më 14 tetor të vitit 2004, maturantët e Gjimnazit “Abdyl Frashëri, përderisa ktheheshin nga ekskursioni në Shqipëri, në afërsi të Fushë Arrëzit, njëri autobus me maturantë, kishte pësuar aksident, me ç’rast kishte dalë nga rruga dhe kishte përfunduar në një humnerë. Në këtë tragjedi, patën humbur jetën 15 maturantë, dhe ishin lënduar shumë të tjerë.

Të gjithë maturantët të cilët humbën jetën në atë aksident tragjik, janë të varrosur në një vend, tek i cili është i ngritur një lapidar, në shenjë nderimi dhe kujtimi për ta.



Filloi ndërtimi i nënkalimit në Astrazup

Malishevë, 18 tetor

Ka filluar ndërtimi i nënkalimit në fshatin Astrazup, projekt shumë i nevojshëm për banorët e këtij fshati dhe në veçanti për nxënësit e shkollës. Ky projekt ndërtohet në bashkëpunim të Komunës së Malishevës dhe Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), programi Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive në Kosovë (DEMI).

Ndërtimi i nënkalimit në këtë fshat, është shumë i rëndësishëm për 461 nxënësit e Shkollës së Mesme të Ulët (SHMU) “Ganimete Tërbeshi”, të cilët duhet ta kalojnë magjistralen për të shkuar në shkollë dhe për rreth katër mijë banorë të këtij fshati.

“Me ndërtimin e këtij nënkalimi, krijohet një siguri më e madhe për nxënësit e shkollës sonë, gjatë vajtje-ardhjes së tyre”, tha drejtori i shkollës “G.Tërbeshi”, Shemsi Morina, pasi “viteve të kaluara kanë ndodhur gjashtë raste të aksidenteve me fatalitet, gjatë kalimit të rrugës”.

Nënkalimi, është në vazhden e realizimit të projekteve të shumta të qeverisë komunale, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, përfshi edhe krijimin e kushteve më të mira për nxënësit.

Vlen të përmendet se, punimet është duke i kryer kompania NNT “Kosova ERH” & “Kotori” sh.p.k, kurse pritet të përfundojnë brenda një muaji, varësisht edhe prej kushteve atmosferike.

RCPI do të hap pusin e ujit për shkollën e Astrazupit

Malishevë, 21 tetor

Rotary Club Prishtina International (RCPI), do të mundësoj hapjen e pusit, për të siguruar ujin për pije, për shkollën “Ganimete Tërbeshi” në Astrazup. Këtë përkrahje të RCPI-së, e ka konfirmuar Kryetar i



Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, pas takimit që ka pasur me përfaqësuesit e Rotary Club Prishtina International.

Hapja e pusit për këtë shkollë, e cila ka mungesë të ujit për pije, pritet të filloj brenda një jave, ndërsa shuma e ndihmës që do të ofroj është Rotary Club Prishtina International, është rreth katër mijë euro.

“Sigurimi i ujit për këtë shkollë, është në vazhden e angazhimeve të qeverisë komunale, për kushte më të mira për nxënësit e komunës sonë”, është shprehur kryetari i komunës z. Isni Kilaj.

Komiteti për Arsim mbajti mbledhjen e dytë të radhës

Malishevë, 25 tetor

Komiteti për Arsim, i themeluar nga Asambleja Komunale, ka mbajtur sot mbledhjen e dytë të radhës, ku është diskutuar për gjendjen e përgjithshme të arsimit në Komunën e Malishevës.

Anëtarët e Komitetit për Arsim, në mbledhjen e sotme, kanë diskutuar për fillimin e vitit të ri shkollor 2011-2012, ku edhe është bërë një analizë e përgjithshme e çështjeve të këtij fillim viti shkollor.

Propozimet nga mbledhja e këtij komiteti, do të prezantohen në njërin nga mbledhjet e ardhshme të Asamblesë Komunale.

Vlen të përmendet se ky komitet është i përbërë prej pesë anëtarëve.

Komuna dhe FSK-ja ndërtojnë rrugën në Fshatin e Ri

Malishevë, 26 tetor

Komuna e Malishevës, në bashkëpunim me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), kanë filluar sot ndërtimin e rrugës për Fshatin e Ri. Në ceremoninë e fillimit të punimeve, morën pjesë Kryetari i Komunës së



Malishevës, z. Isni Kilaj, me zyrtarë tjerë komunla, pastaj z. Haxhi Shala nga Ministria e FSK-së dhe eprori i lartë i FSK-së, Enver Dugolli.

“Është privilegj për neve, kur ushtarët tanë të FSK-së, ndërtojnë rrugë”, tha kryetari Kilaj, duke folur për këtë bashkëpunim mes Komunës dhe FSK-së. Ndërsa duke folur për rëndësinë e ndërtimit të rrugës për këtë fshat, kryetari Kilaj, tha se “për çdo vit, po ndërtojnë infrastrukturën në çdo cep të Malishevës, duke përfshi edhe fshatrat më të thella, siç është në këtë rast edhe Fshati i Ri”.

“Pa komunën, as ne nuk do të mund të bëjmë këtë punë që po bëjmë sot”, tha eprori i lartë i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Enver Dugolli.

Rruga e cila ka filluar të ndërtohet në Fshatin e Ri, është e gjatë rreth dy kilometra, ndërsa në këtë fazë të ndërtimit, do të bëhet zgjerimi i rrugës dhe shtrimi i bazës për asfaltim.

Kryetari Kilaj priti qytetarët për dy orë

Diskutohet për hallet dhe problemet e tyre

Malishevë, 27 tetor

Në takimin e sotëm për më shumë se dy orë, kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur qytetarët e kësaj komune. Me këtë rast janë diskutuar shumë çështje në lidhje me kërkesat e tyre individuale.

Kërkesat e qytetarëve ishin nga më të ndryshmet. Duke u bazuar në mundësitë dhe kompetencat e komunës, kryetari Kilaj, u ka dhënë përgjigje secilit veç e veç.

Përveç kësaj, qytetarët janë ndihmuar në lidhje me orientimin në raste të kontesteve pronësore (ngase kishte edhe probleme të kësaj natyre), si psh, dalja e gjeodetëve në përcaktimin e pikave kadastrale në bazë të regjistrave aktual, etj.



Midis MAPL-së dhe komunës

Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e rrugës në fshatin Rud

Malishevë, 31 tetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Besnik Osmani, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për ndërtimin e rrugës në fshatin Rud.

Sipas kësaj marrëveshje “projekti për ndërtimin e rrugës në fshatin Rud, ka vlerën parallogaritare prej 133,333.00 euro”. Poashtu sipas marrëveshjes në fjalë, MAPL do të financojë shumën prej 40 mijë euro, ndërsa pjesën tjetër komuna e Malishevës.

Ky është edhe njëri ndër projektet , në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës rrugore që janë bërë dhe po bëhen gjatë këtij viti në territorin e komunës së Malishevës, përfshirë këtu fshatrat më të thella të kësaj komune.

Vlen të theksohet se kjo rrugë është e gjatë 1350 m, ndërsa e gjerë 5 m.

Asambleja Komunale, mbajti mbledhjen e njëzet të radhës

Raportohet për fillim vitin 2011-2012 dhe miratohet raporti për zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave

Malishevë, 31 tetor

Asambleja Komunale e Malishevës, sot ka mbajtur mbledhjen e njëzet të radhës, ku është prezantuar raporti i drejtorisë komunale për arsim, për fillimin e vitit shkollor 2011-2012, si dhe është miratuar raporti i mbajtjes së zgjedhjeve në fshatrat e Komunës së Malishevës.



Drejtori i Drejtorisë komunale për Arsim, z.Isuf Morina, ka prezantuar raportin e fillimit të vitit shkollor 2011-2012, ku ka paraqitur para këshilltarëve komunal, të gjitha përgatitjet e bëra për një fillim të mbarë të vitit shkollor, si dhe për infrastrukturën përcjellëse.

Drejtori Morina, është përgjigjur edhe në pyetjet e këshilltarëve, si dha ka dëgjuar edhe vërejtjet dhe sugjerimet e këshilltarëve komunal.

Po ashtu në këtë mbledhje, është shqyrtuar dhe miratuar raporti i komisionit komunal për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në fshatrat e komunës së Malishevës, dhe me këtë miratim nga ana e Asamblesë, prej sot, edhe zyrtarisht fshatrat e komunës së Malishevës, kanë të zgjedhur kryetarët e fshatrave.

Ministri i Republikës së Shqipërisë, Myqerem Tafaj vizitoi Malishevën

Tafaj: Qendra e Kompetencës, shkollë me standarde evropiane

Malishevë, 31 tetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, drejtori i komunal i arsimit, z.Isuf Morina dhe drejtori i Qendrës së Kompetencës, z.Besim Dobruna, kanë pritur sot në takim, Ministrin e Arsimit, në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, z.Myqerem Tafaj, i cili shoqërohej nga ministri i Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z.Ramë Buja.

Ministri Tafaj, ka vizituar Qendrën e Kompetencës në Malishevë, me ç'rast drejtori Dobruna, e ka njoftuar me ambientet e brendshme të kësaj qendre arsimore, me kushtet e mësimi, sistemin e mësimdhënies dhe infrastrukturën e përgjithshme, ndërsa ministri Tafaj, u shpreh i ngazëllyer me kushtet dhe sistemin e mësimi këtu.



“E vizituam një qendër moderne të arsimit profesional, kjo qendër është e standardeve më të mira evropiane dhe unë urojë që edhe ne në Shqipëri të kemi mundësi të ndërtojmë një qendër të tillë”, ka thënë ministri Tafaj duke i uruar suksese drejtorit Dobruna. “Edhe në Evropë shkollat e tilla janë të rralla”, është shprehur Ministri i Arsimit i Republikës së Shqipërisë, z.Myqerem Tafaj.

Ndërsa, kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, e ka quajtur “ngjarje të jashtëzakonshme, vizitën e dy ministrave shqiptar të arsimit, në Malishevë”. Urojë gjithashtu që nisma e dy ministrive për Abetare të përbashkët të ketë sukses.